

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian DVORANI - Kryesues
Arjana FULLANI - Anëtar
Evelina QIRJAKO - Anëtar
Andi ÇELIKU - Anëtar
Medi BICI - Anëtar

në seancë gjyqësore të datës **07.02.2017**, mori në shqyrtim çështjen administrative që i përket:

PADITËS: **Bashkim Sheraj**

I PADITUR: **Drejtoria e Policisë Vlorë**

OBJEKTI: Kthim në punë. Detyrimin e palës së paditur për të paguar dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara.

BAZA LIGJORE: Neni 7, i ligjit Nr.9381, dt.28.04.2005 “Per kompesimin e burgimit te padrejte”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin Nr.706, datë 17.03.2009, ka vendosur: Rrëzimin e padisë, ngritur nga paditësi Bashkim Sheraj kundër Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë, me objekt detyrimin e të paditurit të pranojë rikthimin ne pune te paditësit, si e pabazuar ne ligj dhe ne prova. Shpenzimet gjyqësore paditësit.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.1, datë 10.01.2012, ka vendosur: Ndryshimin e Vendimit nr.706, datë 17.03.2009, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në këtë mënyrë:

1. Anullimin e urdhrit Nr.97/38, datë 06.03.2008, të Drejtorit të Policisë së Qarkut Vlorë, për largimin nga puna te paditësit Bashkim Sheraj.
2. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, ti paguajë paditësit Bashkim Sheraj një dëmshpërblim në masën e 12 muajve page.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, ka paraqitur rekurs, pala e paditur Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr.1, datë 10.01.2012...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 63, të Ligjit nr.49, datë 03.05.2012 të “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

VENDOSI

Lënien në fuqi të vendimit nr. 1, datë 10.01.2012 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Tiranë më 07.02.2017

**Nr. 11241-01487-00-2012 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2017-39 i Vendimit (24)**

Dixhitalizuar dhe Perpunuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik
www.infocip.org